



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 143 datë 22.12.2021

**Për lënien në fuqi të VKB-së nr. 135 datë 25.11.2021 “Për dhënien e ndihmës  
financiare z. Dhimitër Dolani dhe znj. Vasilika Dolani për dëmet e shkaktuara  
nga rënia e zjarrit në banesën e tyre”**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe bazuar në kreun III pika 1/b të VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose nga veprimtaria njerëzore”, nenit 16 pika 2/b të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

**VENDOSI**

1. Të lërë në fuqi VKB-në nr. 135 datë 25.11.2021 “Për dhënien e ndihmës financiare z. Dhimitër Dolani dhe znj. Vasilika Dolani për dëmet e shkaktuara nga rënie e zjarrit në banesën e tyre” .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Finances.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Erjon Nexhipi**

